



Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 282/23 dhe 27 dhjetor 20223

Në bazë të nenit 30 paragrafi 1 alineja 1, 2 dhe 6 të Ligjit për tregti (*) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/04, 128/06, 63/07, 88/08, 159/08, 20/09, 99/09, 105/09, 115/10, 158/10, 36/11, 53/11, 148/13, 164/13, 97/15, 129/15, 53/16, 120/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 77/21, 215/21, 295/21 dhe 150/22), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 26 dhjetor të vitit 2023, miratoi

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR KUSHTE TË VEÇANTA PËR TREGTIMIN E MALLRAVE TË CAKTUARA, PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE MË TË LARTA PËR DISA PRODUKTE NË TREGTINË ME PAKICË, SI DHE DETYRIMIN E TREGTARËVE PËR FURNIZIMIN DHE SHITJEN E DISA LLOJEVE DHE SASIVE TË MALLRAVE TË CAKTUARA PËR KONSUMATORËT SIPAS RENDITJES SË CAKTUA

Neni 1

Në Vendimin për kushtet e veçanta për tregtimin e mallrave të caktuara, përcaktimin e çmimeve më të larta për produkte të caktuara në tregtinë me pakicë, si dhe detyrimin e tregtarëve për të furnizuar dhe shitur lloje dhe sasi të caktuara të mallrave të caktuara për konsumatorët në një renditje të caktuar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 195/23, 202/23, 203/23 dhe 227/23) në nenin 6, fjalët "31 dhjetor 2023" zëvendësohen me fjalët "31 janar të vitit 2024".

Neni 2

Në Vendimin për ndryshimin e Vendimit për kushte të veçanta për tregti me mallra të caktuara, përcaktimin e çmimeve më të larta për produkte të caktuara në tregtinë me pakicë, si dhe detyrimin e tregtarëve për të furnizuar dhe shitur lloje dhe sasi të caktuara të mallrave të caktuara për konsumatorët në një renditje të caktuar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.202/23) në nenin 3, fjalët "31 dhjetor të vitit 2023" zëvendësohen me fjalët "31 janar të vitit 2024".

Neni 3

Në Vendimin për kushtet e veçanta për tregtimin e mallrave të caktuara, përcaktimin e çmimeve më të larta për produkte të caktuara në tregtinë me pakicë, si dhe detyrimin e tregtarëve për të furnizuar dhe shitur lloje dhe sasi të caktuara të mallrave të caktuara për konsumatorët në një renditje të caktuar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së



Maqedonisë së Veriut” nr. 203/23) në nenin 2, fjalët “31 dhjetor të vitit 2023” zëvendësohen me fjalët “31 janar të vitit 2024”.

Neni 4

Në Vendimin për ndryshimin e Vendimit për kushte të veçanta për tregti me mallra të caktuara, përcaktimin e çmimeve më të larta për produkte të caktuara në tregtinë me pakicë, si dhe detyrimin e tregtarëve për të furnizuar dhe shitur lloje dhe sasi të caktuara të mallrave të caktuara për konsumatorët në një renditje të caktuar (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.227/23) në nenet 5 fjalët “31 dhjetor të vitit 2023” zëvendësohen me fjalët “31 janar të vitit 2024”.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi të nesërmen nga dita e publikimit të tij në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. viti 2023 Shkup	Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut Dimitar Kovaçevski n.p.
---------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------